

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 571 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 37, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Qyteti Mesjetar i Drishtit (Shkodër)"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita (IA), doktorant Paulin Pushimaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Qyteti Mesjetar i Drishtit (Shkodër)"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Luan Përzhita (IA), doktorant Paulin Pushimaj, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Plotësim i dokumentacionit grafik, pjesa e jug-lindore dhe jug-perëndimore e mureve rrethuese të Varoshit.
 - Pastrim dhe evidentim i planimetrisë së kishës IV në Varosh.
 - Pastrim dhe evidentim i planimetrisë së kishës VI në kodrën e Muzhilës.
 - Sondazhe gjurmimi për njohjen me stratigrafinë brenda mureve rrethuese të Varoshit dhe Citadellës".
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë Maj-Korrik 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe eksopzimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

